

VENDIM
Nr. 76, datë 7.6.2016

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË OST SHA
PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR PERIUDHËN 1 KORRIK 2016 – 31 DHJETOR 2016**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike” neneve 18, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, i ndryshuar, vendimin nr. 59, datë 29.12.2005 “Metodologjia e llogaritjes së tarifës së aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2016, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 korrik 2016 – 31 Dhjetor 2016, dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Çmimeve dhe Tarifave,

konstatoi se:

- Aplikimi plotëson kryesisht kërkesat e përcaktuara në rregullat e ERE-s, për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2016.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të OST sh.a., për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., për periudhën 1 korrik 2016 – 31 dhjetor 2016.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqërinë OST sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti